



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:157510
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05470632

C.nr.1099/19

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Shaban Shala, me sekretaren juridike F.B. në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.M. nga Prizreni rr.Janina pn të cilin e përfaqëson av.V.O. kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, me datën 19.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

NDËRPRITET procedura në këtë çështje juridike kontestimore për shkak të fillimit të procedurës së likuidimit, bazuar në vendimin Nr.70-24/2021 e lëshuar nga BQK.

Procedura e ndërprerë do të vazhdoj kur administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik e merr përsipër apo kur gjykata i thërret ta bëjnë këtë me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësi B.M. nga Prizreni rr.Janina pn të cilin e përfaqëson av.V.O. në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Kosova e Re” me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit.

Duke i analizuar shkresat e kësaj lënde, e posaçërisht duke u bazuar në deklarinimin e të autorizuarit të paditësit av.V.O. të dt.19.03.2024 si dhe duke marr për bazë vendimin e BQK-së nr.23-10/2019 me të cilin revokohet licenca nr.007 e dt.25.04.2002 lëshuar nga BQK dhe hapet procedura e likuidimit të detyrueshëm gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 277 par.1 pika d lidhur me nenin 280 par.1 të LPK duke ndërprerë procedurën për shkak të fillimit të procedurës së likuidimit-falimentimit.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

**Departamenti i përgjithshëm
C.nr.1099/19, datë 19.03.2024**

Sekretare juridike
Feriha Brando

Gjyqtari
Shaban Shala

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, pas marrjes të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.